



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 194 Prot.

Tiranë, më 9/5/2011

Lënda: Rekomandim për Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë,**

KONSTATOVA

Më datë 07/02/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë,** cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (katëgoritë e subjekteve, pedagogë, studentë, punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5,6,7,8.9 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- Si zbatohen të të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese.

Komisioneri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" pasi shqyrtoi materialet e kontrollit administrativ, (proces-verbalin e konstatimit të shkeljeve, relacionin etj,) si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi, **Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë**, në Formularin e Njoftimit ka disa mangësi dhe rubrika që janë deklaruar jo në mënyrë të plotë, si më poshtë:

Kontrolluesi, **Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë**, në Formularin e Njoftimit ka disa mangësi dhe rubrika që janë deklaruar jo në mënyrë të plotë, si më poshtë:

- Kontrolluesi tek **Rubrika 2** nuk ka plotësuar, fushën e veprimtarisë "edukim";
- Kontrolluesi tek **Rubrika 4** nuk ka plotësuar, qëllimin e përpunimit "edukim";
- Kontrolluesi tek **Rubrika 5** nuk ka plotësuar, kategorinë e të dhënave të subjekteve "punëmarrës", pasi ligjërisht stafi akademik dhe personeli administrativ janë punëmarrës.
- Kontrolluesi tek **Rubrika 6** nuk ka plotësuar, kategorinë e të dhënave personale "numri i sigurimit shoqëror", "foto", "numri personal i identifikimit", "jeta profesionale" (pjesa më e madhe e dosjeve të stafit akademik përmbanin CV);
- Kontrolluesi tek **Rubrika 7** ka plotësuar, se nuk përpunohen të dhëna sensitive, ndërkohë u konstatua se, nga kontrolluesi mbahen të dhëna sensitive që ijanë "gjëndja penale"(stafi akademik dhe administrativ ka të depozituar në dosje dëshminë e penalitetit).
- Kontrolluesi tek **Rubrika 9** ka plotësuar, se nuk transferon të dhëna personale, ndërkohë u vërtetua se ishin bërë transferime të dhënash në Kanada; Për pasojë nuk janë plotësuar as nënrubrikat 9.2.2, 9.2.3, 9.2.4 dhe 9.2.5 të formularit të njoftimit.
- Kontrolluesi tek **Rubrika 10** ka plotësuar se ka dokument të qartë për mbrojtjen e të dhënave, tek **nënrubrika 10.1**, por u konstatua që nuk ka një dokument të tillë; Ndërkohë në nënrubrikën 10.1, gjithashtu është deklaruar se ka rregulla që lejojnë kontrollin e aksesit në përpunimit e të dhënave personale ndërkohë, këto rregulla nuk janë të përcaktuara qartazi.
- Kontrolluesi tek **Rubrika 10.2** nuk ka deklaruar se çfarë masash sigurie merren në rastin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale””, “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë” dhe 23 të ligjit “ Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor”.
2. Kontrolluesi, **Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë**, nuk ka të hartuar një rregullore të posaçme lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, në rregulloren e brendshme ekzistuese nuk janë shprehur në lidhje me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale.
- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27/2 “c” i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ”.....Udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë , në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave “. dhe neni 28 i ligjit, “Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit”.
3. Kontrolluesi, **Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë**, nuk ka rregulla të përcaktuara për aksesin e kufizuar tek sistemet e të dhënave në mënyrë manuale dhe sidomos në sistemin kompjuterik, të përpunimit të të dhënave. Nuk janë përcaktuar në mënyrë eksplicite dhe të shkruar personat përgjegjës, të drejtat dhe detyrimet e tyre.
- Përsa i përket programit kompjuterik me anë të të cilit përdoret mënyra e koduar ku studentët, pedagogët apo persona të stafit administrativ informohen në lidhje me rezultatet në provime, programet e lëndës, të dhëna të rregjistrave të ndryshëm me të dhëna personale etj, dhe kanë mundësi të shikojnë të dhënat e tyre në mënyrë individuale me anë të kodit përkatës, vlerësojmë se kjo praktikë është një praktikë e avanacuar që garanton mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e tyre.
- Megjithatë, në lidhje me këtë program, u konstatua se, nuk janë përcaktuar në një dokument të shkruar personat përgjegjës që kanë akses në databasin e këtij programi. Kjo është shumë e rëndësishme për vetë tërësinë e informacionit që disponon ky program i cili praktikisht ishte i njëjti me gjithë informacionin që mbahet në mënyrë manuale.
- Gjithashtu, nuk janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të shkruar detyrat e punonjësit IT , të drejtat dhe detyrimet e tij dhe të personave të tjerë që kanë akses

në procese të tilla si grumbullimi, rregjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi etj.

Theksojmë se, për të dhënat që përpunohen manualisht është po aq e rëndësishme, të përcaktohen në mënyrë të shkruar (psh. përshkrim pune, Job Description), të drejtat dhe detyrimet e personave të cilët kanë akses në dokumentat që mbajnë të dhëna personale, kjo në funksion të sigurisë së këtyre të fundit. Edhe për këto dokumenta nuk janë të përcaktuara me shkrim personat përgjegjës dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27 pika 2/a,b të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”, “.....”Kontrolluesi merr këto masa sigurie:....përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave; përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar”.*

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* kontrolluesi, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, duhet të riformuloj Formularin e njoftimit duke plotësuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i inspektimit dhe të bëra të ditura kontrolluesit nëpërmjet procesverbalit dhe pjesës arsyetuese të këtij rekomandimi.
2. Në zbatim të neneve 3, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, kontrolluesi, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, duhet të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregulloren ekzistuese seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.
3. Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të dhënave personale”*, kontrolluesi, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, duhet të përcaktojë rregulla të qarta dhe në një dokument të shkruar, personat përgjegjës që kanë akses në programin kompjuterik me anë të të cilit përdoret mënyra e koduar ku studentët, pedagogët apo persona të stafit administrativ informohen në lidhje me rezultatet në provime, programet e lëndës, të dhëna të rregjistrave të ndryshëm me të dhëna personale etj, detyrat e punonjësit IT , të drejtat dhe detyrimet e tij dhe të personave të tjerë që kanë akses në procese të tilla, si grumbullimi, rregjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi etj, tek të dhënat personale që përmban ky program.

Gjithashtu, për të dhënat që përpunohen manualisht, të përcaktohen në mënyrë të shkruar të drejtat dhe detyrimet e personave përgjegjës të cilët kanë akses në dokumentat që mbajnë të dhëna personale, kjo në funksion të sigurisë së këtyre të fundit.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

